REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 110/17
Datë/Datum. 14.04.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Deçanit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **631/17/277/521**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.N. '' Asfalti '' sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gjin Gazuli lok 2/3
(Adresa)

Pejë — *30.000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/128-025 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ismajl Hulaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

asfalti@ipko.net ; mirjetamazrekaj@hotmail.com
(Adresa elektronike)

11.04.2017
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

NËRMARRJA NDËRTIMORE SH.P.K. ASFALTI Pejë, Bellopojë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate : Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan me dt. 22.02.2017 *Njoftim mbi Anulimin e Anulimin e Aktivitetit te prokurimit me dt.04.04.2017* *Kerkesa per Rishqyrtim e dt. 06.04.2017* *Vendimi mbi Refuzim i miratuar nga AK me dt. 07.04.2017*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes ka qene pa verejtje – kane dorezuar ofertat e tyre plotë 7 kompani

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

*Po, me daten 06.04.2017 bashkëngjitur keni **Kerkesen per Ri-Shqyrtim** dhe një kopje te vendimit te **Refuzimit** nga AK te dates 07.04.2017 konform me nenin 108A te LPP-se. Kerkesa per Ri-Shqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues behet konform rregullores per parashtrimin e ankesave nxjerre nga KRPP-ja me dt. 22.06.2016 , konform nenit 4 paragrafi 4.1 nen a . brenda afatit kohorë.*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 – Barazia ne trajtim – jo diskriminim
Neni 60 – Kriteret per dhenje te kontrates
Neni 62 – Anulimi i AP
Neni 108/A Zgjedhja e kontestit preliminar ne mes te AK dhe OE

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 7 , Jemi te diskriminuar sepse me dt. 29.03.2017 , permes telefonit zyrtari i prokurimit Xhevdet Ramosaj nga nr. 044/178-837 ne nr. e menagjerit te OE " Asfalti " shpk nr. tel 044/128-025 në oren 9:54 , duke na kerkuar dokumentet ATK dhe Certifikaten e Gjykates , te cilat dokumente kerkohen vetem per perfituesin , e ne kete raste ne jemi OE i cili ka plotesuar te gjitha kriteret dhe kemi ofruar çmimin më te ulet konform **nenit 60 paragrafi 1.1** . Ne brenda afatit te paraparë ligjorë , kemi deponuar dokumentet e kerkuara pran zyrave te prokurimit ne Komunen e Deçanit para ores 12:00 te dates 31.03.2017. Keto dukumente siq e parashef ligji kerkohen vetem pasiqe komisioni i vleresimit te tendereve e ka perfunduar punën e vleresimit dhe ka Rekomanduar OE per dhenje te kontrates , andaj e gjitha sipas ligjit neve si OE i rekomanduar per dhenje te kontrates na kerkohen edhe Dokumentet ne fjale. Diskriminim eshte sepse AK pasiqe ne e plotesojm kete kriter , atehere vjene deri te Anulimi i AP. - Neni 60 , Shkelje e rende e nenit 60 , qe eshte kriteri kryesor ne kete AP ku diset se tenderi i ipet OE qe eshte i përgjegjegjshëm dhe ka ofruar çmimin më të ulët , - **Neni 62 –** Jeni ne kundershtim te plotë me ketë nene ju si Autoritet Kontraktues sepse nje AP mund te Anulohet vetem kur plotesohen keto kushte dhe asesi ne kete arsyetim , sepje ju ne njoftimin per Anulim theksoni : Për shkak se me datën 22.03.2017 sipas nenit 39.2 te LPMF-së janë terheke nga Buxheti i Komunës së Deçanit tek një EO, nga kodi ekonomik 31230 mjetet e parapara për këtë Aktivitet të Prokurimi , ky fakt nuk qendron sepse ju edhe pas kesaj date keni vazhduar me vleresim dhe kur nuk keni arritur qellimet per te cilat ne nuk jemi ne dijeni Zotimi per kete AP eshte 490.000,00 ndersa oferta jonë është : 369.930,00 € (Brenda zotimit) Nje AP sipas Lpp-së mund te anulohet ku plotesohen keto kushte si psh. 1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji

kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit. 2. Kur njoftimi i kontratës është publikuar dhe procedura e prokurimit është anuluar pa dhënien e kontratës publike, autoriteti kontraktues duhet që të publikojë njoftimin e anulimit në formën dhe përmbajtjen e informatave përcaktuar nga KRPP-ja, dhe (ii) të përfshijë në të dhënat e prokurimit të kërkuara nga paragrafi 1. i nenit 10 të këtij ligji, një deklaratë me shkrim që parashtron me hollësi arsyet faktike dhe bazën ligjore për anulimin.

Shkelje e nenit 108/A , AK sipas mendimit tone nuk ka analizuar fare ankesen tone dhe si rrjedhoje ka dhene nje pergjigjeje kunderthenese , psh. Zotimi per projekt : 490.000,00 € oferta jone financiare : 369.930,00 , kemi mbetje prej : 120.070,00 € , pra shuma e terjekur nga thesari per kete projekt eshte 100.000,00 € , po te ishte realiteti keshtu AK do te kishte ne dispozicion edhe 20.070,00 € te tjera teprice nga kodi ekonomik 31230 .

Kerkojm qe Ankesa e jonë te Aprovohet si e Bazuar dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në Ri-Vlerësim

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Sipas LPP-së nr.04/L-042 e plotesuar dhe ndryashuar me Lppnr. 04/L-237 , ligin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 ne jemi te demtuar dhe ne si OE qe i plotetosjm te gjitha kriteret e kerkuara nga AK , vjen deri te anulimi , plotesiht i pa-bazuar duke pasur parasyshe se po ky AP qe anuluar edhe njehere gjate muajit Nentor te vitit 2016– Demtohemi si OE per te dyten here radhazi ne po kete AP , anulimi i kaluar shume skandaloze dhe tani qe nuk gjendet zgjadhja e deshiruar , qe ne te ardhmen me nenshkrimin e kesaj kontrate mund te kemik perfitimi afatgjate sepse projekti eshte dy-vjeqare dhe Kompania jone ka nevoje per nje kontrate te tille , demet jane te konsiderueshme per neve si OE ankues , dhe ne do te kerkojm nga organet kopetente nje zhdemtim ne raste te mos Ri-vleresimit te drejte nga ana e AK- Deçan.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të kerkeses per Ri-Shqyrtim
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,
e) një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) Letren Standarte ne lidhje me Anulimin e AP
h) Procesverbali i komisionit vlersues , Certifikata e zotimit te mjeteve per projektin .

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*